

VENDIM

Nr. 7, datë 30.04.2021

MBI

**“MIRATIMIN E TARIFËS SË KONKURRIMIT, TARIFËS SË RREGJISTRIMIT,
TARIFËS SË SHKOLLIMIT PROGRAM I PARË STUDIMI SI DHE TARIFËS SË
SHKOLLIMIT PROGRAM I DYTË STUDIMI, PËR TË GJITHA PROGRAMET E
STUDIMIT TË OFRUARA NGA FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE,
PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”**

Mbështetur në pikat 28, 29, dhe 30, të nenit 6 dhe nenit 38 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Arteve nr. 6, datë 27.04.2021 “Mbi propozimin për miratimin e tarifës së konkurrimit, tarifës së rregjistrimit si dhe tarifës së shkollimit program i parë dhe i dytë studimi, për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakultetet e Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2021-2022”; nisur dhe nga propozimet mbi deklarin e tarifës së konkurrimit, tarifës së rregjistrimit si dhe tarifës së shkollimit program i parë dhe i dytë studimi, për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakultetet e Universitetit të Arteve, bashklidhur këtij vendimi dhe më konkretisht shkresave të Fakultetit të Muzikës me nr. 23/1 prot., datë 10.05.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 115/1 datë 01.03.2021), Fakultetit të Artit Skenik me nr. 100 prot., datë 24.02.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 136 datë 24.02.2021) dhe të Fakultetit të Arteve të Bukura me nr. 15 prot., datë 01.03.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 144 datë 02.03.2021) dhe pasi e diskutoi me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së konkurrimit, tarifës së rregjistrimit si dhe tarifës së shkollimit program i parë dhe i dytë studimi, për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakultetet e Universitetit të Arteve, sipas tabelave bashklidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim ti dërgohet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky vendim ti dërgohet Administratores dhe Fakulteteve të Universitetit të Arteve për zbatim.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

